



Pranimi / Prizim / Primenje / Prizanje / Received / Delivered	14. 10. 2022	2	viti god year
Organ / Rjesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sheria Kolicina Quantity
SKANSHCK	6239/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.812/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari- dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.812/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.10.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.812/2022 e datës 21.09.2022, e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në pozitën "Koordinator i Zyrës Regjionale në Mitrovicë", në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me datën 21.09.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5543/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me lëshimin e vendimeve për pëlqim sanitar nga ana e Drejtorit Ekzekutiv pranë kësaj agjencie, me që rast sipas tij janë diskriminuar inspektorët në AVUK pasi që të njëjtëve i'u është mohuar e drejta për lëshimin e këtyre vendimeve-pëlqimeve sanitare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 30.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 5543/2022 të datës 21.09.2022 në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.10.2022 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimin nr.6324/1 të datës 12.08.2022 për pëlqim sanitar nga ana e Drejtorit Ekzekutiv-AUV; Vendimin nr.6250/1 të datës 10.08.2022 nga ana e Drejtorit Ekzekutiv-AUV; Vendimin 6154/1 të datës 05.08.2022 nga ana e Drejtorit Ekzekutiv-AUV; Vendimin 6639 të datës 05.09.2018 nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të AUV-së; Përshkrimin e detyrave të vendit të punës të datës 17.03.2014 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimin 1013 të datës 03.02.2022 nga Zv. Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Vendimin 3209 të datës 04.05.2022 nga Zv. Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 24.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa ne Vendim me numër protokolli 3581/2022 e datës 20.06.2022 nga ankuesi; Përgjigje në kërkesë për ankesë me numër protokolli 4727 të datës 01.07.2022 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimin me numër protokolli 4509/22 të datës 03.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", andaj ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson se mbi bazën e arsyeve të kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.812/2022 e datës 21.09.2022, e parashtruar nga ankuesi është e palejuar.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.812/2022, datë 14/10/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesi
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

